



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 07, dt. 30.06.2021

### **MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 09 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

### VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e Fondit Rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2021 në vlerë 100 mijë lekë.
2. Fondi prej 100 mijë lekë do të përdoret si kontribut financiar për Bashkinë Pogradec në kuadër të aktiviteteve që do të zhvillohen për festën e zonës së Mokrës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi L.Pleqi  
Juristi Gj. Kristo  
Sek.K.qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### ***MBI PERDORIMIN E FONDIT REZERVE TE KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2021***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2021”, Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit paraqet para Keshillit të Qarkut kërkesen për përdorimin e fondi rezerve për vitin 2021.

Bashkia Pogradec dhe grupi organizativ kanë marrë masat për organizimin e ditës festive të zonës së Mokres, feste kjo që tashmë ka hyrë në kalendarin e festave lokale. Organizimi i kësaj feste ka për qëllim promovimin e vlerave historike, kulturore dhe folklorike të kësaj zone.

Sa me sipër Bashkia Pogradec dhe grupi organizativ i kanë kërkuar Keshillit të Qarkut mbështetje financiare në vlerë 100 mijë leke për të bërë të mundur financimin e shpenzimeve të nevojshme për organizimin e aktiviteteve për këto ditë festive.

Mbështetur në kjo kërkesë i propozojmë Keshillit të Qarkut miratimin e përdorimit të fondi rezerve të planifikuar për vitin 2021 në vlerë 100 mijë leke si kontribut financiar për Bashkinë Pogradec për organizimin e ditës festive të zonës së Mokres.

Korce, më 21.06.2021

Drejtoreshë e Financës  
Liljana Pleqi